

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Shala, kryetar i kolegjit, Valon Totaj dhe Lumni Sallauka, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses N.T.SH “NN”, me seli në Rahovec, të cilin e përfaqëson A.S. pronar i Ndërmarrjes, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson me autorizim B.O., për shkak të mos përmbushjes së kontratës, vendosur përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë–Dega në Rahovec, C.nr.252/12 i datës 28.08.2014 në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.08.2018 mori:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec C.nr.252/2012 i datës 28.08.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë është miratuar kërkesëpadia e paditëses N.T.SH “NN” me seli në Rahovec dhe është detyruar e paditura Komuna e Rahovecit që për shkak të mos përmbushjes së kontratës t’ja paguaj paditëses borxhin në shumën prej 4.782,00€ me kamatë sipas mjeteve të deponuara pa destinim të caktuar duke filluar nga data 30.06.2010 deri në pagesën përfundimtare si dhe t’ja kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 150,00€.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me kohë ka paraqitur ankesë e paditura Komuna e Rahovecit, për shkak shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazë, ose aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së I-rë në rigjykim dhe vendosje.

Paditësi N.T.SH “NN” nga Rahoveci, ka dhënë përgjigje në ankese me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, ekzaminojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufinjëve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e

dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.2 pika b), g), j), k), m) të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se tani paditësi në Gjykatën Komunale në Rahovec me datën 10.12.2010 ka paraqitur propozim për përmbarim kundër tani të paditurit përkatësisht debitorit Komuna e Rahovecit. Debitori Komuna e Rahovecit në afatin ligjor ka paraqitur prapësim duke i kontestuar shkaqet dhe arsyet për të cilat është caktuar përmbarimi.

Gjykata e shkallës së parë pasi që është paraqitur prapësimi nga debitori, propozimin për përmbarim të kreditorit e ka konsideruar si padi dhe tani ka vazhduar me trajtimin e çështjes sipas rregullave të procedurës kontestimore. Gjykata e shkallës së parë pasi ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka administruar provat, si : Ka lexuar marrëveshjen për mirëmbajtjen e kamionëve dhe aparateve kundër zjarrit me Nr.31/09 të datës 09.07.2009; faturën nr. 15/10 të datës 30.06.2010; faturën nr. 16/10 të datës 05.07.2010; aneks kontratën nr.675 të datës 16.06.2009; kontratën me nr.305 të datës 13.06.2008; regjistrin e punëve dhe pjesëve rezervë për mirëmbajtje të automjetit të datës 30.05.2008; rekapitullimin e çmimeve nga ofertuesi NATSHT “MM” në Rahovec; ekspertizën e ekspertit mekanik A.S. të datës 19.07.2014.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi me të paditurën kanë arritur marrëveshje dypalëshe, ku paditësja ka marrë për obligim që ti kryej të gjitha shërbimet për mirëmbajtje, riparim të kamionëve të zjarrfikëseve dhe mirëmbajtjen e aparateve kundër zjarrit, ndërsa e paditura e ka marrë për detyrim që në emër të këtyre punëve t’ja bëjë kompensimin financiar paditësit sipas faturave të cilat do ti faturojnë. Nga faturat nr. 15,16 gjykata e shkallës së parë ka përfunduar se e paditura i ka mbetur borxh paditësit shumë prej 4,782,00€. Këtë gjykata e shkallës së parë, e ka vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të makinerisë A.S. i cili e ka vlerësuar punën e kryer nga paditësi tek i paditura dhe ka konstatuar e paditura i ka mbetur borxh paditësit për punët e kryera dhe riparimet sipas marrëveshjes në shumë prej 4,782,00€. Gjykata e shkallës së parë, mbi bazë të këtyre provave ka vërtetuar gjendjen faktike duke zbatuar dispozitën e nenit 122 të LMD-së edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurës, për përfshirjen e aktgjykimit të ankimuar me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore. Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të paditurës, ngase sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm, po ashtu dispozitivi i aktgjykimit nuk është në kundërshtim me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsyet e mjaftuara për faktet vendimtare, për provat me të cilat janë vërtetuar këto fakte dhe për besueshmërinë e tyre.

Po ashtu, gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë. Siç rezulton nga shkresat e lëndës, e paditura përmes drejtorit të saj të shërbimeve publike ka lidhur marrëveshje me paditësen për mirëmbajtjen e kamionëve dhe aparateve të zjarrit të shërbimit të zjarrfikësve. Kjo kontratë është nënshkruar prej të paditurës dhe paditësit, ku janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese si dhe kohëzgjatjen e kësaj marrëveshje. Sipas kësaj marrëveshje, paditësja ka marrë për detyrim që të bëjë mirëmbajtjen, riparimin e kamionëve të zjarrfikësve, e po ashtu të bëjë mbushjen dhe mirëmbajtjen e aparateve kundër zjarrit, ndërsa Komuna do të ja bëjë kompensimin për punën që do të kryej sipas faturave që do të ja sjell paditësi të paditurës. Po ashtu, gjendjen faktike në këtë drejtim përveç faturave nr.15,16, e vërteton edhe ekspertiza e ekspertit A.S. si inxh. i dipl. Eksperti, në ekspertizën e tij ka konstatuar se vlera e pjesëve për ndërrim që janë bërë nga paditësi në kamionin e markës “Zastava VPS 1600” shumën prej 2005,00€; vlera e punës dhe e pjesëve për riparim shumën prej 321,00€; vlera e materialit të konsumit, lysterja dhe rregullimi në tërësi i lemerise së kamionit është 1500,00€ apo shumën e përgjithshme prej 3.826,00€, ndërsa tek kamioni tjetër i markës “FAP 1314-K” vlera e pjesëve për ndërrim ka kushtuar rreth 740€, ndërsa vlera e pjesëve për riparim ka kushtuar 250€, apo vlera e përgjithshme prej 990,00€.

Mbi bazë të kësaj rezulton se gjendjen faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore e të paditurës përkitazi me çështjet se drejtoria për urbanizëm, shërbime komunale, kadastër, gjeodezi, pronë dhe mjedis kur kanë arritur marrëveshje me paditësin në vitin 2009 kanë vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik të Kosovës, ngase i vetmi autoritet për lidhje të kontratave ka qenë Zyra e Prokurimit e të paditurës dhe jo drejtoria e lartë cekur. Gjykata e Apelit vjen në përfundim se në rastin konkret marrëveshja duhet të përmbushet nga e paditura, pasi që nuk është faji i paditësit për këtë pasi që ai nuk e ka për detyrë të kujdeset për procedurat administrative që duhet të ndjek e paditura para se të nënshkruaj kontratën. Në rastin konkret është jo relevante se a është dashur të lidhet kontrata përmes procedurës së prokurimit apo jo. Relevante, në rastin konkret është arritja e marrëveshjes dhe kryerja e detyrimeve nga kontraktuesit, dhe siç rezulton paditësi i ka kryer detyrimet kontraktuese prandaj e paditura duhet ta përmbush obligimin e saj kontraktues. E paditura, është dashur të kujdeset kur ka lidhur këtë marrëveshje me paditësin, se a është lidhur në pajtim me ligjin për prokurimin publik apo jo, mirëpo ajo nuk mund ti shmanget përgjegjësisë për mos përmbushjen e detyrimit ndaj paditësit, përderisa ajo i ka pranuar shërbimet e paditësit

dhe paditësi e ka përmbushur detyrimin e tij kontraktues, dhe kjo më së miri është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të makinerisë A.S..

Gjithashtu, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurës për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së parë mbi bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, pasi që në raportin kontraktues e paditura duhet ta përmbush detyrimin e saj ndaj paditësit pasi që ky i fundit i ka kryer shërbimet, siç janë përcaktuar me kontratë.

Nga të cekurat më lartë, e duke u mbështetur në nenin 194, 195 parag.1 pika d), 200 të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4860/14 datë 06.08.2018

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Burim Shala, d.v

